



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.184/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarjen e zyrtares ligjore Fitore Isufi, duke vendsur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Rahovec, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të nxitjes së urrejtjes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Rahovec, ndërkaq subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 3.000,00 (tremijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Me datën 11.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se me datën 08.10.2017, kandidati për kryetar të Komunës së Rahovcit, Visar Korenica, ka ndërmarr veprim të ndaluar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, duke publikuar material të shëmtuar, lidhur me kandidatin për kryetar të Komunës së Rahovcit, nga radhët e PDK-së, Idriz Vehapi. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e nenit 3.1 të Rregullores për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave Nr.01/2012.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 12.10.2017 subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë, duke arsyetuar se Facebook-u i kandidatit për Kryetar të Komunës së Rahovcit, Visar Korenica, menaxhohet nga disa vullnetarë të asaj qendre dhe kështu ata nuk e kanë ditur se një veprim i tillë është i pa lejuar sipas rregullave zgjedhore. Më tej subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), thekson se ka ndërmarrë masa të menjëhershme në drejtim të largimit të asaj fotoje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se subjekti politik LVV, ka keqpërdorur posterin e kandidatit për Kryetar të Komunës së Rahovecit, nga radhët e subjektit politik PDK, me të cilën me këtë veprim ka nxit urrejtje, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33.1 pika i) Kodit të Mirësjelljes, e cila përcakton: “*Përdorimi i gjuhës në formën e shkruar apo gojore, që nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt tjetrit, duke publikuar fotografi, që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LVV, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtë janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre paneli gjeti se brenda afatit të caktuar ka bërë evitimin e shkeljes. Ndërsa, masat që janë ndërmarrë për evitimin e shkeljes, nga Paneli janë vlerësuar pozitivisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi se dënim i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitesa**

ZL.Anr.184 /2017 më datën 16.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**

Hasan Shala

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4të LZP-së.